



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 13134/2

Vlorë, më: 30.10, 2023

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR

Datë: 09.10.2023 Ora:16:30

Tema: Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Urdhrit nr.11769 datë 4.10.2023.

Marrin pjesë:

Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha, Deputetja- znj. Pranvera Veizi, Kryetarja e Këshillit Bashkiak- znj.Elpinqi Mërkuri, Kryetari i Njesisë Administrative Qendër-Genard Fegaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak-z.Daut Zeraj, Drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, Drejtori i buxhetit dhe financës, sektori i tatim taksave kryetarë të fshatrave të Njesisë Administrative Qendër, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media dhe OJF locale.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 33 persona, listeprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha: Përshendetje, ju falenderoj për pjesëmarrjen! Jemi mbledhur për të diskutuar mbi planifikimin e buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe projektbuxhetin e vitit 2024 per Bashkinë Vlorë. Ky është takimi i tretë që vijon me njësitë

administrative dhe do të vazhdojme me takimet e tjera për të mbledhur cdo koment, sygjërim dhe diskutim tuajin përpara se të miratojmë projekt buxhetin e parashikuar. Jemi informuar nga administrata për problemet dhe shqetësimet që keni dhe sot do i diskutojmë të gjithë së bashku.



Degjesa per Projektbuxhetin 2024 Njesia Administrative Qender

Për më shumë klikoni linkun

<https://fb.watch/nBmK2esEX7/?mibextid=Iprqdp>

Hiqmet Haxhaj Drejtor i Financës në Bashkinë Vlorë – Prezanton ligjshmërinë e takimit për të diskutuar mbi projektbuxhetin e bashkië Vlorë për vitin 2024 si dhe për planifikimin e buxhetit afatmesëm 2024-2026. Është hartuar projektbuxheti sipas programve të miratuara nga këshilli bashkiak dhe do të diskutohet me grupet e interesit në secilën njësi të bashkisë Vlorë. të ardhurat dhe shpenzimet janë parashikuar sipas prioritetit të Planit të Përgjithshëm Vendor 2021-2031 të Bashkië Vlorë në fushën e turizmit, zhvillimit ekonomik, punësimit, transportit, sipërmarrjes sociale, cilësisë së jetës dhe kohezionit social.

Transferrat e pakushtëzuara në formë granti nga qeveria janë:

Viti 2023 rreth 674 milion lek

Viti 2024 ka një rritje 6% - rreth 710 milion lek

Viti 2025 rreth 748 milion lek

Viti 2026 rreth 788 milion lek

Transferrat specifike:

Viti 2023- 447 milion lek

Viti 2024 – 447 milion lek

Viti 2025- 474 milion lek

Shpenzimet e parashikuara për vitin 2024 për 4 njësitë administrative janë rreth 608 milion lek sipas sektorëve prioritar; zjarrfikës-73 milion lek, ujitje dhe kullim 47

Për njësinë Qendër janë parashikuar 130 milion shpenzime përveç investimeve që do të realizohen.

Investimet e parashikuara janë:

- Rikonstrukcion i rrugës Bestrovë Bunavi e cila do të zgjat një vit 2024-2025
- Rikonstrukcion i rrugëve dhe trotuarëve në brendësi të fshatrave rreth 250 mil lek
- Rikonstrukcion i shkollave dhe kopshteve në fshatra
- Ndricimi i rrugëve

Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha – Do të realizohet projekti i ndricimit të Fshatit Zvërnec deri te Manastiri. Është parashikuar në buxhetin e vitit 2024 dhe janë rreth 210 milion lek të vjetra investim.

Pranvera Veizi-Deputete e Qarkut Vlorë.- Të falenderoj për prezantimin dhe të dhënat financiare që ndave me të pranishmit. Do të diskutojmë mbi nevojat emergjente të njësisë e cila deri tani është lënë pak pas dore si: uji, ndricimi, infrastruktura e brendshme dhe zhvillimi i ekonomisë lokale. Të dakortësojmë së bashku për adresimin e nevojave prioritare dhe shtrirjen në kohë të projekteve dhe të jemi konkret në ato që kërkojmë. Ujësjiellësi është një investim i qeverisë por edhe ne do bëjmë pjesën tonë sepse buxheti është instrumenti më madhor i bashkisë.



Degjesa per Projektbuxhetin 2024

Elona Hodaj-Drejtore e Ujesjelles Kanalizime- Dua tju njoftoj se është miratuar Projekti i Ujësjiellës Kanalizimeve për zonën e Zvërnecit dhe Nartës dhe është në procedurën e mbylljes së marveshjeve dhe kontratave.

Kryetari i fshatit Bestrove-

- Bestrova s'ka rrjet të brendshëm ujësjiellësi dhe nuk ka një depo qendrore.
- Rruga që është premtuar dhe parashikuar me projektin 80 mil lek, duhen bërë fillimisht instalimet e tubacioneve të ujit që mos të çahet prapë.

Elona Hodaj- Drejtore Ujesjelles: Kërkesa juaj është marr parasysh nga firma e ndërtimit gjithashtu edhe për ndërtimin e depos dhe zëvendësimin e linjës 63 edhe pse linja furnizon zonën. Tubat do ndryshojnë nga 63 në 110. Do hapet kanali dhe do zëvendësohen.

Ermal Dredha – Do bëhen ndryshimet sipas kërkesave pasi të amendohet dhe kontrata.

Elona Hodaj- Drejtore Ujesjelles: Ky është një shqetësim që e ka marr përsipër kryetari i bashkisë. I kemi kërkuar fondit të zhvillimit të bëj projektimin.

Barish Sadija-Kryetar i fshatit Kaninë- Z. Kryetar faleminderit për ftesën në këtë takim për të na dëgjuar për problemet dhe shqetësimet që ka komuniteti. Në Kaninë kemi këto probleme:

Bypass e ndan fshatin në dy pjesë, perëndimore dhe lindore. Nuk ka akses për hyrje dalje në fshat. Hyrja dhe dalja në fshat është jashtë parametrave të sigurisë rrugore. Të ndërhyet pranë ARSH për të siguruar servitutin e kalimit për banorët si mbikalim, nënkalam, rrugë dytësore. Rrugët për në prona. Rruga për në breg 70% duhen 30% nga bashkia. Duhet rruga për në Sherisht për në prona. 30% nga komuniteti.

Landfilli 30-40 familje nuk janë shpërblyer dhe kanë probleme mbivendosje. Të bashkëpunohet me Njësinë Administrative Qendër, prefekturën, dhe drejtorinë M.P.P dhe arkiven. Të caktohet një kamion me topografin e NJ.A.Q për verifikimin në terren të AMTP me qytetarët.

Uji i pijshëm është rrjeti i amortizuar. Të verifikohen në terren ndërhyrjet në rrjet. Uji është me orar nga hidrauliku fshatit. Të studiohet shpërndarja nga specialistët e ujësjellësit që uji të shkoj në të gjithë fshatin.

Pastrimi. Makina e pastrimitvjen por duhen shtuar koshat në Kapllanaj dhe Neliraj. Të vij makina e mbledhjes së mbeturinave sepse ka mbetje si divanë, karrige, inerte etj. Të bëhet disinfektimi në kosha me gëlqere.

Elektriku. Të menaxhohet sistemi elektrik duhen 3 shtylla dhe kablli, nuk ka tension, janë djegur. Ndricimi i lagjeve 25 drita.

Mjeku. Nuk ka mjek.

Probleme janë dhe Gropat septike.

Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha: Menaxhimi i mbetjeve duhet rregulluar dhe do ta bëjmë.

Zaho Kapaj- Kryeplaku i fshatit Kërkovë: Rruga e Kerkovës është 2 km dhe izolon 3 fshatra. Rruga brenda fshatit rreth 400m është problem dhe vështireson kalimin për 40 familje.

Jaho Alliu: Ne Novoselë po bëhen punimet e ujësjellësit dhe janë sipas standarteve që duhen, të gjitha të reja. Nga ne është keq. Rrjeti i brendshëm është keq. Në Panaja nuk është vënë dorë prej 30 vitesh. Sistemi rrugor është i amortizuar, rruget janë me gropa, nuk ka ndricim.

Edmond Habilaj-Kryetar i Fshatit Babicë e Vogël: Duhet të bëhet ndricimi i 1000m rrugë që të cojnë të varrezat e fshatit.

Lavdosh Hoxhaj - Kryetar i fshatit Sherisht: Kërkojmë rikonstrukcionin e rrugës së Sherishtës. Ndricimi ka probleme. Nevojiten ndërrimi i llampave. Furnizimi me ujë ka probleme.

Avdul Yzeiri - Banor i Babicës: Ujësjellësi në Babicë ka probleme, skemi ujë, furnizohemi një herë në dy ditë. Varrezat 100 vjecare duhet të shpërngulen të varrezat e qytetit dhe të rikonceptohet

zona me parqe apo ambiente sportive. Kanalizimet kanë probleme dhe rruget ne lagjet e brendshme janë me gropa dhe te cara. Zjarret marrin permasa sepse jane mbyllur rruget ekzistuese mes ullinjve.



Degjesa per Projektbuxhetin 2024
Njesia Administrative Qender

Avdul Yzeiri-Kryeplak i Fshatit Babice- Nuk ka mjek ne fshat.

Altina Dema Banore në Xhyherinë - Kemi problem rrugët, vendosjen e koshave, kanalizimet, menaxhimin e zonës sepse krijon problem edhe te bizneset. Si dhe rikonstruksionin e shkollës.

Islam Isaraj-Oshtimë: Shperndarja e rrjetit te brendshem te ujësjellësit.

Anesti Koreta-Kryetar i fshtatit Zvernec: Problemi I tokave qe po zaptohen. Të na ndihmoj shteti dhe nëse na takon toka ta marrim sepse jemi me AMTP prej 30 vitesh dhe po na marrin tokat.

Ermal Dredha Kryetari i Bashkisë: Takimi ishte për projektbuxhetin dhe problematikat e fshatrave. Ato që na takojnë do ti zgjidhim.

Vangjel Profka - Kryeplaku i fshtatit i Nartës: Ndricimi dhe kanalizimet.

Znj.Elona Hodaj- Drejtore Ujesjelles: Eshtë miratuar projekti.

Banor i Babicës: Në buxhet duhet të parashikohen investime për projektin e Babicës dhe do një studim për kanalizimet dhe ujrat e zeza, të planifikohet.

Konceptoi: Albana Naçi

Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik